




**MANUAL MBI MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE NË  
FUSHËN E MEDIAS**



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE**

**Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen  
e të Dhënave Personale**

**Tiranë 2013**

## Hyrje

Liria e shtypit konsiderohet si thelbësore në një shoqëri të lirë dhe demokratike. Liria e shprehjes, nga njëra anë, do të thotë e drejta e çdo personi për të shprehur mendimet e tij, dhe nga ana tjetër, çdo njeri duhet të marrë në konsideratë interesat e të tjerëve dhe të shtetit.

Është pranuar tashmë se të drejtat themelore të individit nuk janë të pakufizuara dhe kufizimi qëndron pikërisht aty ku e drejta e individit ndeshet në radhë të parë me të drejtën konkrete të një individi tjetër, apo kur peshorja anon dukshëm nga interesi publik dhe jo nga interesi i ngushtë i individit. Në këtë kuptim, kushdo që përpunon të dhëna personale vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike, do të ndeshet në radhë të parë me të drejtën e individit, subjekt i këtyre të dhënave personale, për t'i mbrojtur ato.

Ruajtja e konfidencialitetit si një e drejtë themelore e individit për mbrojtjen e të dhënave të tij, nuk duhet të dalë si një pengesë e dorës së dytë, ndaj të drejtës së lirisë së shprehjes së gazetarit apo çdo subjekti tjetër të parashikuar sipas këtij neni. Është e vërtetë se liria e shprehjes nuk i nënshtrohet censurës paraprake, por kjo censurë nuk ka të bëjë me mospasjen e të drejtës së individit për të mbrojtur të dhënat e tij personale. Duhet pasur parasysh që e drejta e jetës private të përshtatet me rregullat që rregullojnë lirinë e të shprehurit.

E drejta e lirisë së shprehjes së gazetarit rregullohet e kufizohet me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Kodin etik të gazetarit, i

cili do të përcaktojë standarde në sjelljen e gazetarëve dhe do jetë dhe një mbrojtje për vetë gazetarin.

### **Bazat ligjore për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe të drejtave të njeriut në Republikën e Shqipërisë**

Ushtrimi i së drejtës së lirisë së shprehjes kërkohet të bëhet brenda kontureve të kërkesave të parashikuara në nenet 15, 17, 35, 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë pasi të drejtat themelore të njeriut janë të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik dhe se ato mund të kufizohen vetëm me ligj.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 22 të saj parashikohet :

*1.Liria e shprehjes është e garantuar.*

*2.Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar.*

*3.Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet.*

*4.Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit.*

Sipas Vendimit të GJK 16/2004 “*Liria e shprehjes përbën një nga gurët themelorë të shtetit demokratik. Pa garantimin e kësaj të drejte nuk mund të bëhet fjalë për pluralizëm, tolerancë dhe krijim të vullnetit të lirë politik, aq të domosdoshëm për shoqërinë demokratike...Liria e shprehjes është gjithashtu bazë dhe kusht i domosdoshëm paraprak për garantimin e një sërë të drejtave dhe lirive të tjera themelore”.*

Dispozita e sipërme e ligjit është në harmoni të plotë me parashikimet ne Direktivën 95/46 të KE, ku parashikohet :

*“Për përpunimin e të dhënave me karakter personal që realizohen ekskluzivisht për qëllime gazetarie ose ne kuadrin artistik ose ne shprehjen letrare, vendet anëtare parashikojnë përjashtimet ose devijimet nga dispozitat e këtij kapitulli, të kapitullit 4 dhe 6 vetëm në shkallën që është e nevojshme në mënyrë që e drejta e jetës private të përshtatet me rregullat që rregullojnë lirinë e të shprehurit”.*

Po kështu kjo dispozitë është në harmoni dhe me nenin 10 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut ku parashikohet:

*“1. Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione ose mendime pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të vendosin një regjim autorizimesh për institucionet e radiodifuzionit, të kinemasë, ose të televizionit.*

*2. Ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara nga ligji që, në një shoqëri demokratike, përbëjnë masat e nevojshme për sigurimin kombëtar, integritetin territorial ose sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e informatave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”*

Ndër ligjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, të aplikuara në mënyrë të drejtpërdrejtë, sa më poshtë janë të një rëndësie të veçantë:

- ✚ Ligji nr.8137, datë 31.7.1996 Për ratifikimin e Konventës Evropiane “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”; amenduar sipas Protokollit n° 11 shoqëruar nga Protokollit shtojcë dhe Protokollit n° 4, 6 e 7.
- ✚ Ligj nr.9288, date 7.10.2004 “Për ratifikimin e Konventës Nr. 108 "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale".
- ✚ Ligji nr.9287, date 7.10.2004 Për ratifikimin e protokollit shtesë të Konventës 108 "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale nga organet mbikëqyrese dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave".
- ✚ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.

Gjithashtu Akte të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me median janë si më poshtë:

- ✚ Udhëzim nr. 9, datë 15/09/2010 për “Rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, i ndryshuar me udhëzimin Nr. 32, datë 27.12.2012.
- ✚ Udhëzim nr. 31, datë 27.12.2012 për “Përcaktimin e kushteve dhe kritereve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”.

## Një përshkrim i shkurtër i manualit

Manuali synon të nxisë trajtimin e drejtë të jetës private të **figurave publike**, si dhe të **personave të zakonshëm** nga ana e medias, shtypit, medias elektronike dhe mediat e reja (sidomos bloget). “Ndershmëria” nënkupton që media të arrijë një ekuilibër të ndërmjetëm, nga njëra anë e drejta e individëve për të marrë informacion të plotë dhe të përshtatshëm për aktivitetet e figurave publike dhe në raste të jashtëzakonshme, të personave të zakonshëm, dhe në anën tjetër e drejta legjitime e këtyre personave të cilëve mos t’i shkelet privatësia e tyre.

Ky manual është në përputhje me rezolutat përkatëse të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, të cilat pranojnë se e drejta për privatësi dhe e drejta e lirisë së shprehjes nuk është as absolute dhe as mbizotëruese në ndonjë mënyrë ndaj njëra-tjetrës, pasi ato janë me vlerë të barabartë, dhe duhet të jenë të balancuara. Përveç kësaj, ato jo vetëm që e theksojnë nevojën për të arritur një ekuilibër në mes të ushtrimit të këtyre të drejtave, por në mënyrë specifike bëjnë thirrje në media për të zhvilluar udhëzimet e tyre.

Mbulimi mediatik duhet të jetë në përputhje me standardet e përgjithshme të mbrojtjes së të drejtës së privatësisë, në veçanti, me parimin e saktësisë, proporcionalitetit, transparencës në sigurinë e përpunimit të të dhënave personale (shiko nenin 8 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Konventën 108 “Për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale”) dhe nenin 35 të Kushtetutës.

Manuali trajton çështje që lidhen me ekspozimin mediatik të jetës private si dhe mbulon fazën e mbledhjes së informacionit nga ana e

medias, përcaktimin e standardeve të veçanta që rregullojnë përdorimin e praktikave ndërhyrëse dhe metodave të fshehura për të mbledhur informacionin personal.

Manuali është i ndarë në dy pjesë:

- ✚ Pjesa e parë përcakton parimet e përgjithshme të mbrojtjes së privatësisë së figurave publike, personave të zakonshëm dhe fëmijëve;
- ✚ Pjesa e dytë përcakton standarte të veçanta të zbatueshme për çështje të veçanta të tilla si fotografitë dhe filmimet, hetimet gazetareske, mediat e reja, trajtimi i zgjedhjeve, raportimi i gjykatave dhe siguria e dosjeve të gazetarëve.

Ndërkohë që aplikohen këto standarde të veçanta, duhet të merren parasysh dispozitat e përgjithshme përsa i përket mbrojtjes së privatësisë së personave publikë dhe të zakonshëm, në veçanti në lidhje me interesin e lartë publik. Parimet e përgjithshme duhet të shërbejnë si udhëzues në mungesë të rekomandimeve specifike në situata të caktuara.

## Pjesa e parë:

### Të përgjithshme

#### 1. Figurat publike

**1.1** Figurat publike janë persona që mbajnë poste publike dhe/ose përdorin burime publike dhe, në mënyrë më të gjerë, njerëzit të cilët luajnë një rol në jetën publike, qoftë në politikë, ekonomi, art, sport, në sferën sociale apo në ndonjë fushë tjetër.

**1.2** Media mund të mbledhë dhe të shpërndajë informacion në lidhje me jetën private të figurave publike me pëlqimin e tyre. Gazetarët nuk duhet të përdorin metoda mashtruese për marrjen e pëlqimit.

**1.3** Media mund të ndërhyjë në jetën private të figurave publike pa pëlqimin e tyre vetëm kur ka shfaqje të justifikuar të interesit publik. Një ndërhyrje e tillë duhet të jetë proporcionale dhe të mos shkojë përtej asaj që është e nevojshme për të plotësuar një interes publik legjitim.

✚ Në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, politikanët duhet të presin një shkallë më të ulët të mbrojtjes së privatësisë së tyre, siç ka deklaruar edhe Gjykata "do të jetë fatale për lirinë e shprehjes në sferën e politikës nëse figurat





publike mund të censurojnë shtypin dhe debatin publik në emër të të drejtave të tyre të personalitetit".

**Megjithatë kurioziteti i thjeshtë apo sensacioni nuk mund të justifikojë kurrë shkeljen e të drejtës për respektimin e jetës private.** Në vlerësimin nëse ekziston një interes publik i justifikuar për ndërhyrje në të drejtën për respektimin e jetës private, fokusi duhet të jetë, siç thuhet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, "**nëse publikimi është në interes të publikut dhe jo nëse publiku mund të jetë i interesuar në leximin e tij**".

**1.4** Media mund të ripublikojë të dhënat personale të bëra publike nga vetë figurat publike pa pëlqimin e tyre. Kjo përfshin informacion të dhënë më parë për mediat e tjera dhe të dhënat sensitive ose fotografi të publikuara në internet, në veçanti në profile të arritshme në rrjetet sociale. Edhe nëse qasja në një profil është e kufizuar, një interes i ligjshëm publik mund të interpretohet për ribotim në qoftë se figura publike në mënyrë të qartë përdor profilin e tij/saj për qëllime politike.

✚ Nëse informacioni në lidhje me një figurë publike është zbuluar publikisht nga njerëz të tjerë, media duhet të ushtrojë kufizim para botimit dhe ta bëjë atë vetëm deri në atë masë të kërkuar nga një interes parësor publik.

**1.5** Kundërvajtje të kryera në moshë të mitur ose përpara se personi të jetë bërë një figurë publike nuk duhet të përmenden po të mos ketë ndonjë interes publik për publikimin e tyre.

**1.6** Me qëllim shmangien e ngacmimeve apo kërcënimeve të integritetit personal, vendndodhja e saktë e banesës së figurave publike ose të

anëtarëve të familjes së tij/saj nuk duhet të zbulohet pa pëlqimin e personit të interesuar.

✚ E njëjta gjë vlen edhe për regjistrimin e targave të automjeteve ose numrave të telefonit privat. Një informacion i tillë mund të publikohet përjashtimisht në qoftë se tregon një shkelje apo një sjellje kontradiktore dhe vetëm deri në atë masë që është e domosdoshme për të provuar akuzat e tilla.

**1.7** Fotot e vendbanimeve (të përhershme ose të përkohshme) të një figure publike mund të publikohen pa pëlqimin e tij/saj vetëm në qoftë se ato janë marrë nga një vend i hapur/në dispozicion të publikut dhe nuk dëmtojnë sigurinë dhe masat e mbrojtjes së këtyre objekteve.

**1.8** Informacioni në lidhje me besimin fetar të një figure publike nuk duhet të publikohet pa pëlqimin e tij/saj, përveç rasteve kur ky informacion është bërë tashmë publik nga figura publike, ose ka të bëjë me praktikën e paligjshme fetare ose aderimin në lëvizjet ilegale.

**1.9** Informacioni në lidhje me stilin e jetës të një figure publike mund të zbulohet vetëm nëse figura publike tregon në mënyrë bindëse se ajo çka pretendon të jetë nuk përputhet aspak me realitetin. Kjo lidhet në veçanti në situata kur:

- ✚ Deklaratat publike të figurës publike nuk korrespondojnë me veprimet publike të tij/saj;
- ✚ Sjellja e figurës publike në jetën personale apo familjare bie në kundërshtim me statusin publik të tij/saj (rol, të cilin luan personi në jetën publike), deklaratat ose aktivitete të tjera;

✚ Stili i jetesës së figurës publike nuk është në përputhje me të ardhurat zyrtare të tij / saj ose ai/ajo, posedon pasuri, origjinën e të cilit ai/ajo nuk mund ta shpjegojë.

**1.10** Në mënyrë që të mbrojnë demokracinë, gazetarët kanë një detyrim të rëndësishëm për shpërndarjen e informacionit mbi korrupsionin, duke përfshirë edhe hetimet si për integritetin e politikanëve dhe zyrtarëve publik, ashtu edhe për drejtuesit e kompanive private të rëndësishme. Ekspozimi i informacioneve financiare dhe të pronësisë në mënyrë që të provojnë apo të refuzojnë akuzat për korrupsion përbën një interes legjitim publik mbizotërues ndaj jetës private.

**1.11** Sjellja e papranueshme nga të afërmit, si dhe nga miqtë e ngushtë apo kolegët profesionale të një figure publike nuk duhet t'i atribuohen atij apo asaj, përveç në rastet kur figura publike ka kontribuar për të, në mënyrë eksplicite ose implicite dhe ka toleruar këtë sjellje, ose është përpjekur ta mbulojë atë. Përveç kësaj, duke mos qenë figura publike në vetvete, këta persona gëzojnë një shkallë më të lartë të privatësisë.

**1.12** Informacioni rreth pasurisë së luajtshme (si automjetet ose aksionet në një kompani), ose e paluajtshme (tokë ose rezidenca) pronë që i takon të afërmeve apo miqve të ngushtë të një figure publike mund të bëhen publike vetëm nëse është e nevojshme për të provuar se figura publike aktualisht përfiton prej përdorimit të tyre.

**1.13** Në përputhje me parimin e drejtësisë, media duhet të ofrojë mundësi të shpejta për një figurë publike (ose një person që ka lidhje me një figurë publike) për t'u përballur me shkeljet apo ti neglizhojë. Kur është e mundur dhe në qoftë se kjo nuk do të rrezikonte publikimin e ardhshëm, gazetarët duhet të kontaktojnë dhe të dëgjojnë personin para

publikimit; pikëpamjet e tij/saj duhet të prezantohen ashtu siç janë. Në fund të fundit, kjo është përgjegjësi e organeve editoriale (bordi editorial, shefi i editorialit, etj) të medias për të vendosur për publikimin e materialeve pa dëgjuar këtë person para publikimit.

## 2. Persona të zakonshëm

**2.1.** Duke mos luajtur asnjë rol në jetën publike, **personat e zakonshëm gëzojnë një nivel më të lartë të respektimit të jetës së tyre private.** Në parim, të dhënat e tyre personale nuk duhet të publikohen pa pëlqimin e tyre. Në të njëjtën kohë, për marrjen e një pëlqimi të tillë, një gazetar duhet të shpjegojë qartë, se cilat të dhëna personale do të publikohen, nga kush dhe në çfarë forme.



Fakti që të dhënat personale të personave të zakonshëm janë tashmë të publikuara nga mediat e tjera nuk e justifikon publikimin e tyre të përsëritur. Për përhapjen e një informacioni të tillë pa pëlqimin e personit të zakonshëm, duhet të mbizotërojë një interes publik i tillë që justifikon ri-publikimin.

**2.2.** Përgjashtimisht informacioni në lidhje me një individ mund të publikohet nëse ai/ajo, vullnetarisht ose padashur, tërheq vëmendjen e publikut për shkak të një ngjarje të rëndësishme apo të një incidenti.

- ✚ Zakonisht pacientët e spitalit ose pacientët e çdo institucioni tjetër të ngjashëm nuk duhet të intervistohen pa autorizimin e drejtuesit të institucionit.
- ✚ Përjashtime mund të bëhen, në veçanti në rastet e investigimeve të neglizhencës mjekësore, pakujdesisë në trajtimin e pacientëve, korrupsionit ose ndonjë kontrolli të pavarur të ankesave të pacientit për mjekët dhe personelin tjetër të institucionit mjekësor ose në raste të tjera me nismën e pacientit. Media në çdo rast nuk duhet të intervistojë individët të privuar nga të kuptuarit apo ato të prekur seriozisht nga rrethanat.

### 3. Fëmijët

**3.1.** Të dhënat personale të fëmijëve mund të mblidhen dhe përhapen, si rregull, vetëm me pëlqimin e prindërve të tij/saj ose përfaqësuesve ligjorë.

- ✚ Përjashtime mund të bëhen kur fëmija është person publik (për shembull, sportist) dhe informacioni lidhet me aktivitetin e tij/saj publik, ose kur prevalon interesi publik.



Vëmendje e veçantë duhet t'i jepet pjekurisë së fëmijës, kur citohen komentet e tij/saj. Fëmija mund të mos jetë mjaft i vetëdijshëm për ndikimin e fjalëve të tij/saj dhe media ka një përgjegjësi etike që të mos i shkaktojë dëmtim fëmijës.

**3.2.** Kur ka të bëjë me fëmijë në situata të vështira, për shembull pas një aksidenti dhe/ose në spital, madje **edhe pëlqimi i prindërve ose përfaqësuesve ligjor nuk mund të justifikojë qasjen e fëmijëve për qëllime gazetareske.** Duhet të merret parasysh dëmi që mund t'i shkaktohet interesave të fëmijës nëse shpërndahet informacioni dhe ekzistenca e një interesi publik në situata të tilla.

**3.3.** Vëmendje e veçantë duhet t'i jepet rasteve kur prindërit apo përfaqësuesit ligjorë lëshojnë komente negative, sensitive ose komente të tjera të papërshtatshme për fëmijët, të cilët janë nën kujdesin e tyre. Në interes të jetës private të fëmijës, komente të tilla nuk duhet të publikohen. Megjithatë, në qoftë se publikimi është i nevojshëm për të kënaqur interesin publik, emri i fëmijës nuk duhet të përmendet, në mënyrë që të shmangen komente të përjetshme negative apo të turpshme. Nëse fëmija në fjalë është i pjekur mjaftueshëm dhe i gatshëm për të siguruar përgjigje komenteve rreth tij/saj, këto përgjigje duhet të paraqiten siç shprehen.

**3.4.** Mbledhja dhe publikimi i detajeve të jetës private të një fëmije nuk mund të justifikohet vetëm me qëndrimin që zënë në shoqëri prindërit e tij/saj ose përfaqësuesit ligjorë. Në të njëjtën kohë, një informacion i tillë mund të mblidhet dhe publikohet, në qoftë se është e nevojshme për të treguar sjellje të pahijshme të prindërve (ose përfaqësuesve ligjor) ose kryerja nga ana e tyre e veprave ose akteve të tjera të cilat nuk janë në përputhje me statusin e tyre publik. Qëllimi i informacioneve të tilla nuk duhet të tejkalojë atë që është e domosdoshme për zbulimin e fakteve përkatëse ose mënyrën e jetesës.

## II. Dispozitat e veçanta

Ndërkohë që aplikohen dispozitat e veçanta si më poshtë, duhet të merren parasysh edhe dispozitat e përgjithshme për sa i përket mbrojtjes së privatësisë së personave publikë dhe të zakonshëm, në veçanti në lidhje me një interes të lartë publik.

### 4. Fotografimi dhe filmimi

**4.1.** Media audio-vizuale duhet të jetë e vetëdijshme për faktin se shpesh ka një efekt shumë më të fuqishëm dhe të shpejtë se sa media e shkruar. Publikimi i fotove në përgjithësi duhet të konsiderohet si një ndërhyrje e konsiderueshme në të drejtën për respektimin e jetës private se sa si një komunikim i thjeshtë i emrit të personit.



**4.2.** Fotografimi dhe filmimi i personave në vende private, nuk është i lejuar pa pëlqimin e tyre.

**4.3.** Në vendet publike (për shembull, në rrugë, në transportin publik) individët mund të fotografohen dhe filmohen pa pëlqimin e tyre, nëse këta persona janë pjesë e një turme dhe nuk fokusohen posaçërisht mbi të. Në të njëjtën kohë, është e lejuar për të fotografuar dhe filmuar individë të cilët tërheqin vëmendjen qëllimisht nga veprimet e tyre, nga

pamja apo në një mënyrë tjetër, si dhe ato që marrin pjesë në ngjarje publike (konferenca, protesta, etj), dhe për të shpërndarë foto të tilla dhe video materiale. Në vende potencialisht të ndjeshme, për shembull ambulanca, spitale, shkolla dhe burgje, është gjithashtu i nevojshëm pëlqimi i drejtuesit.

Pavarësisht nga miratimi i drejtuesit të përgjithshëm të institucionit, media nuk duhet të filmojë ose të bëjë fotografi njerëzve që pritet se nuk mund të japin pëlqimin e lirë në mënyrë të arsyeshme, të tilla si për shembull, kur ata janë nën stres në një dhomë të urgjencës.

**4.4.** Fotografitë dhe sekuencat e filmuara të projektuar për të ilustruar një subjekt por që përfaqësojnë njerëz apo situata që nuk lidhen drejtpërdrejt me njerëzit e cituar në artikull ose program, duhet të identifikohen si të tilla. Ato duhet të dallohen qartë nga fotografitë dhe sekuencat e filmuara me karakter informativ apo dokumentar me një ndikim të drejtpërdrejtë mbi faktet e raportuara.

**4.5.** Fotot dhe video montazhet mund të justifikohen vetëm kur ato hedhin dritë mbi një ngjarje, ilustrojnë një supozim, ofrojnë një këndvështrim kritik ose përmbajnë një element satirik. Megjithatë, këto montazhe duhet të kuptohen qartë si të tillë në mënyrë që lexuesit dhe shikuesit të jenë të mbrojtur nga çdo rrezik i konfuzionit.

**4.6.** Lejohet fotografimi dhe filmimi i përfaqësuesve të autoriteteve publike (p.sh. policët, punonjësit e shërbimit të shtetit, prokurorët) kur ata janë duke kryer detyrat e tyre.



## 5. Hetimet gazetareske

**5.1.** Media duhet të mbledhë informacion në lidhje me jetën private të personave në mënyrë të hapur dhe të drejtë.

Regjistrimet e fshehta dhe hetimet e fshehta, nëse kryhen nga media ose me ndihmën e të tjerëve, duhet të përdoren vetëm kur nuk ka alternativë tjetër të arsyeshme dhe më pak ndërhyrëse për të mbledhur prova në lidhje me gabime serioze.



**5.2.** Përdorimi i lenteve të gjata për të bërë fotografitë nga një distancë e madhe cënon të drejtën e jetës private kur imazhet tregojnë të dhëna personale të cilat nuk janë të dukshme për botën e jashtme. Fakti që teknologjia është në dispozicion për “të zmadhuar” mbi njerëzit, veshjet e tyre, banesat e tyre private dhe gjërat që ata kryejnë së bashku, të tilla si fotografi letre, çanta me sende personale, telefonat, dhe pajisje Internet / audio / video, nuk legjitimon përdorimin e teknologjisë për të shkelur mbi jetën private.

- ✚ Lente të gjata mund të përdoren vetëm në vende publike për të demonstruar përfundimisht praninë apo veprimet e figurave publike, në rrethanat ku ata mund të jenë të vetëdijshëm për filmimin / fotografimin dhe vetëm nëse ka interes qenësor publik në mbledhjen dhe përhapjen e këtyre imazheve.

**5.3.** Regjistrimet e fshehta (nëpërmjet kamerave të fshehta ose mikrofonave, apo pajisje ndërhyrëse audio-video) ose hetimi i fshehtë mund të përdoren vetëm me vlerësimin e thellë të rrethanave të rastit, në varësi të një rëndësie të veçantë për publikun, si dhe ekzistenca e një metode më pak e bezdisshme për të mbledhur informacionin e nevojshëm. Vendimi për përdorimin e metodave të fshehta të hetimit gazetaresk duhet të merret nga niveli më i lartë i drejtimit ekzekutiv të mediave.

**5.4.** Fshehtësia e rreptë e telekomunikacionit duhet të respektohet, kështu që media duhet të përmbahet nga përgjimi ilegal ose pirateria e telefonit ose tekst mesazheve, pavarësisht nëse ata i kryejnë këto akte me nismën e tyre ose me ndihmën e të tjerëve. E njëjta rreptësi fshehtësie zbatohet për përmbajtjen e telefonave të vjedhura apo të humbura dhe të gjitha llojet e tjera të pajisjeve elektronike të komunikimit.

Përmbajtja e komunikimit privat të politikanëve që është kapur nga ekranet e pajisjeve të komunikimit me ndihmën e lenteve të gjata apo bisedave të përgjuara nga një distancë e gjatë me ndihmën e mikrofonave mund të përdoren nga media vetëm në raste shumë të jashtëzakonshme kur ka një interes publik thelbësor (si në rastet e korrupsionit apo mashtrimit që përfshin politikanë të rangut të lartë) dhe vetëm nëse informacioni që do të mblidhet nuk mund të merret me ndonjë mjet tjetër më pak të bezdisshëm. Edhe në këto kushte të veçanta, vendimi për të kapur dhe/ose për të publikuar informacionin e mbledhur në mënyrë të tillë të padrejtë, duhet të merret në nivelin më të lartë të drejtimit ekzekutiv të mediave.

**5.5.** Ambientet private duhet të respektohen në çdo rrethanë, në veçanti media duhet të largohet menjëherë nga një pronë private, nëse urdhërohet për të bërë këtë nga pronari i pronës dhe duhet të shmanget nga dhunimi i pronës.

Një informacion i tillë mund të mblidhet dhe publikohet përjashtimisht në qoftë se ajo përfundimisht demonstroi një shkelje apo sjellje kontradiktore të një personi publik, dhe vetëm në atë masë që është e domosdoshme për të provuar akuza të tilla.

**5.6.** *Doorsteppings*<sup>1</sup> do të përdoret vetëm nëse personi ka refuzuar në mënyrë të përsëritur dhe pa ndonjë arsye të argumentuar, për t'u intervistuar ose për t'u filmuar apo regjistruar dhe informacioni është i rëndësishëm.

## 6. Media e Re

**6.1.** Media, që lejon komente të drejtpërdrejta nga audiencia të cilat publikohen në internet, duhet të verifikojë - me nismën e tij ose me kërkesë të një personi - nëse publikimi



i të dhënave personale të përfshira në këto komente është i justifikuar nga një interes qenësor publik. Nëse komenti nuk përmbush këtë provë, media duhet të fshijë përmbajtjen sa më shpejt të jetë e mundur nga faqja

---

<sup>1</sup> "Doorstepping" është veprimi kur një gazetar përballet dhe regjistron, apo përpiqet për të regjistruar, një intervistë me dikë për transmetim, ose njofton se një telefonatë është duke u regjistruar për transmetim, kur ky person nuk pret për t'u intervistuar për transmetim për shkak të mungesës së ndonjë marrëveshje për ta bërë këtë (shih Editorial Udhëzimet BBC 7.4.30)

e internetit publikisht e dukshme. Në të njëjtën kohë media duhet të sigurojë një procedurë të thjeshtë dhe të arritshme për të paraqitur një ankesë.

**6.2.** Një element i rëndësishëm i së drejtës për lirinë e shprehjes është e drejta për të mbledhur informacione lirisht. Në këtë kontekst, respektimi i privatësisë së lexuesve në internet është vendimtarë. Edhe pse përdorimi i mediave të reja të tilla si faqet e internetit, blogs, apps dhe e-lexuesit, mundëson një analizë shumë më të detajuar të zakoneve dhe preferencave të lexuesve individual, një analizë e tillë mund të pengojë seriozisht ushtrimin e së drejtës për të mbledhur informacion.

- ✚ Media duhet të respektojë të drejtën e lexuesit për të mos identifikuar veten, drejtpërdrejt ose tërthorazi.
- ✚ Media mund të kërkojë regjistrim me detajet e kontaktit të njerëzve (për verifikim) që dëshirojnë të postojnë komente publike, por duhet të lejojë përdorimin e pseudonimeve në publikimet online.
- ✚ Media duhet të kërkojë pëlqimin e informuar të lexuesve të tyre (për të dyja palët, si abonentët që paguajnë për akses në një version të ri të medias dhe për vizitorët e përgjithshëm që nuk paguajnë) përpara se të gjurmojë sjelljen e tyre, për shembull, me ndihmën e cookies të përhershme ose (pajisje) për shenjat e gishtave.

Kjo përfshin cookie të vendosura nga rrjetet e reklamave. Me qëllim për të mbrojtur privatësinë e lexuesve, dosjet hyrëse që përmbajnë informacion në lidhje me sjelljen e vizitorit, të tilla si adresa IP dhe emrat e përdoruesve, duhet të **anonimizohen** sa më shpejt të jetë e mundur.

## 7. Mbulimi i zgjedhjeve

**7.1.** Për shkak të natyrës thelbësore të zgjedhjeve për qeverisjen demokratike, media ka të drejtën dhe detyrën për të siguruar votuesit me informacion të gjerë dhe të balancuar mbi kandidatët (dhe kandidatët e ardhshëm), si dhe zyrtarët e zgjedhjeve dhe personat e tjerë që lidhen me organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, si vëzhgues, pjesëmarrës në fushatën elektorale apo personave të pranishëm në qendrat e votimit.



**7.2.** Kur është fjala për balancimin e argumenteve në favor të zbulimit të informacionit personal dhe argumenteve kundër tij, konsideratë duhet t'i kushtohet të drejtës së votuesve për t'u informuar plotësisht në lidhje me sjelljen e kandidatit, si dhe për çdo shkelje të mundshme të zgjedhjeve lidhur me legjislacionin nga kushdo.

**7.3.** Gjatë fushatave zgjedhore, justifikohet me interes qenësor publik, një shqyrtim rigoroz i informacionin të mëposhtëm rreth kandidatit:

- sjellja e paligjshme, në veçanti, shkelje të lidhura me qeverisjen publike, të tilla si korrupsioni, përvetësimi;
- mashtrimi elektoral, manipulim votimi dhe çdo shkelje tjetër gjatë procesit zgjedhor;
- paaftësia profesionale apo neglizhenca;
- konflikti ndërmjet diskursit politik dhe sjelljeve private.

Lidhur me zyrtarët zgjedhorë ose persona të tjerë të lidhur me procesin zgjedhor, shqyrtimi i sjelljes jo të mirë në vijim është i justifikuar nga një interes qenësor publik:

- shkelje të legjislacionit zgjedhor;
- njëanshmëri politike në kundërshtim me detyrën e një personi për të qëndruar i paanshëm (p.sh. komisionerët, policët) apo etikën profesionale (gazetarët);
- çdo sjellje tjetër që mund të ndikojë në rezultatet e zgjedhjeve apo pengojë padrejtësisht një votim të lirë dhe të informuar.

**7.4.** Edhe pse konsiderohen shumë të ndjeshme në rrethana normale, të dhënat mbi shëndetin apo trajtimet mjekësore mund të zbulohen, përjashtimisht, nëse ato tregojnë se kandidati është i paaftë fizikisht ose mendërisht për të mbajtur detyrën.

## 8. Krimi dhe raportimi

**8.1.** Publiku ka të drejtë të informohet në lidhje me krimet e kryera, si dhe rreth hetimit, ndjekjes penale dhe gjyqimit të çështjeve penale.

Megjithatë media duhet të raportojë në mënyrë të paanshme dhe të lirë nga çdo paragjykim dhe të shmangi publikimin e akuzave të pabaza dhe të paverifikuara.



Prandaj media duhet të shmangë shfaqjen publikisht të një personi si fajtor përpara se ai/ajo të dënohet nga një gjykatë. Në veçanti, raporti duhet të specifikojë nëse personi i akuzuar u vetë deklarua fajtor ose jo fajtor. Një rrëfim i fajit nuk duhet të paraqitet si një fajësi e dëshmuar(vërtetuar).

**8.2.** Praktika më e mirë gazetareske është të mos përmendin emrat e plotë të një personi të dyshuar apo akuzuar, dhe të përdorin në vend të tyre pseudonime ose iniciale, përveç nëse ai person ka shfaqur hapur përfshirjen e tij/saj në publik, për shembull, duke mohuar të gjitha akuzat.

Emri dhe/ose foto të një të dyshuari ose të akuzuari (apo ndonjë detaj tjetër që do të bëjë të mundur identifikimin e kujt do që nuk i përkasin rrethit të tij/saj, të afërmve apo miqve intime) mund të botohet vetëm nëse ka interes publik në identifikimin.

**Ky mund të jetë rasti kur personi i dyshuar ose i akuzuar:**

- ushtron një mandat politik apo është një zyrtar i lartë i rangut publik dhe po ndiqet zyrtarisht për kryerje të krimeve të papajtueshme me funksionin e tij/saj ose;
- është i njohur tashmë në një fushë të caktuar, si dhe për krimet të cilat ai/ajo është akuzuar lidhen me reputacionin e tij/saj në këtë fushë.



### **Publikimi është i lejuar edhe në rastet kur:**

- krimi i kryer është shumë serioz dhe ka shkaktuar frikë apo alarm në mesin e popullsisë, ose;
- publikimi është i domosdoshëm për të shmangur konfuzionin që do të jetë i dëmshëm për një palë të tretë, të tilla si konfuzioni me një person tjetër që punon në të njëjtën zonë dhe/ose ushtrojnë detyra të ngjashme.

**8.3.** Të dhënat personale të individëve të cilët kanë kryer krime apo kundërvajtjeve, në përgjithësi, nuk duhet të bëhen publike, përveç nëse ekziston një interes publik mbizotërues, në veçanti në rastet e veprave penale të korrupsionit.

✚ Publikimi i të dhënave personale të të miturve të dyshuar, të akuzuar ose të dënuar mund të justifikohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe për një rëndësi ekstreme të këtij informacioni për t'u diskutuar në publik.

✚ Media, gjithashtu, duhet të shmangë publikimin e emrave të të afërmeve apo miqve të të miturve, të dyshuar të akuzuar ose të dënuar, përveç nëse një përshkrim i tillë është i domosdoshëm për një raportim të plotë dhe të mirëfilltë për krimet e kryera ose procedura gjyqësore.

**8.4.** Me përjashtim të figurave publike, të dhënat personale të viktimës së një krimi nuk do të publikohen pa pëlqimin e viktimës ose, nëse viktima është vrarë, pa pëlqimin e një të afërmi të tij/saj.

**8.5.** Media nuk duhet të publikojë të dhënat personale të dëshmitarit të një veprave penale.

**8.6.** Nëse media ka mbuluar procesin gjyqësor të një personi, duhet të raportojë dhe shfaqësimin. E njëjta gjë vlen edhe për hetimin. Forma e



shpalljes së pafajësisë duhet të jetë në proporcion me reportazhin e mëparshëm për personin e dyshuar ose të akuzuar.

**8.7.** Në mënyrë që të mos pengojë risocializimin, media nuk duhet të kujtojë krimet e vjetra të kryera nga një person i cili ka shlyer dënimin e tij/saj. Kjo pikë nuk do të zbatohet në qoftë se ky person kryen krime të reja apo aspiron për një pozitë të lartë në shoqëri.

## **9. Siguria e dosjeve të të dhënave gazetareske**

**9.1.** Gazetarët mund të mbajnë fotografi me të dhëna personale për referencë në të ardhmen dhe për qëllime hetimore. Ata duhet të përcaktojnë dhe të marrin masa të arsyeshme organizative dhe teknike të sigurisë së nevojshme për të parandaluar shkeljet e të dhënave, ose aksesin e paautorizuar.



## **Përfundime**

Në përgjithësi, e drejta e privatësisë (së bashku me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale), si dhe e drejta e shprehjes dhe informimit, mund të konsiderohet si të drejta të rëndësishme të njeriut të cilat shpesh mund përplasen, për këto arsye gazetarët duhet të kryejnë punën e tyre duke treguar ndjeshmëri, ndërsa informacioni që ata përcjellin duhet të jetë i vërtetë, i përditësuar dhe i verifikuar.

Raportimi nuk duhet të jetë fyerje ndaj atyre që janë subjekt i tij, dhe nuk duhet të ndërhyjë në privatësinë e tyre. Vëmendje të veçantë duhet të tregohet kur përfshihen të miturit ose persona të rrezikuar.

Prandaj, interesat e të drejtës së individit për privatësi së bashku me interesin publik dhe të drejtën për lirinë e shprehjes, pa të cilat nuk ka të drejtë ndërhyrje në të dhënat personale, duhet gjithmonë të peshohen.

### **KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

**Adresa:** Rr. e Kavajës, Nd.80, H.1, Tiranë

**Telefoni:** +35542237200

**E-maili:** [info@idp.al](mailto:info@idp.al)

**Website:** [www.idp.al](http://www.idp.al)